



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
MINISTRI**

Nr. 4328/1 prot.

Tiranë, më 04.06.2021

URDHËR

Nr. 238, datë 04.06.2021

**PËR
DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE ME
PATOGENITET TË LARTË TË SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË SHTETIN E
GREQISË**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, neni 43, i Ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, informacioni i marrë nga faqja zyrtare e Organizatës Ndërkombëtare të Mbrojtjes së Shëndetit të Kafshëve (OIE), si dhe bazuar në Kodin Shëndetësor të Kafshëve të Tokës dhe Ujit të OIE-së,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë, nga territori i shtetit të Greqisë për ndarjen administrative Maqedoni dhe Trake specifikisht për rajonet Imathia, Thassaloniki, Pella, Kilkis, Pieri, Serres, Chalkidiki, Thasos, Kavala, Drama, Xanthi, Rhohdope dhe Evros; ndarja administrative Epir dhe Maqedonia Perëndimore specifikisht rajonet Thesprotia, Ioannina, Arta, Preveza, Florina, Grevena, Kastori dhe Kozan për:
 - a. shpendëve të gjallë shtëpiakë dhe të egër;
 - b. zogjtë 24 orësh;
 - c. shpendë dekorativë;
 - ç. materialit biologjik të shpendëve;
 - d. vezët e shpendëve;

- dh. mishi i shpendëve;
- e. nënproduktet e shpendëve.

2. Çertifikata veterinare të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.
3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht, Drejtorinë e Politikave dhe Programeve të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë dhe të egër, zogjtë 24 orësh, shpendë dekorativë, materialit biologjik, vezët e shpendëve, mishi i shpendëve dhe nënproduktet e shpendëve që vijnë nga vendet e sipërcituara në pikën 1.
4. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Programeve të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural, Drejtoria e Politikave dhe Programeve të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

